



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 771/2 Prot.

Vlorë më, 19. 03. 2026

VENDIM

Nr. 05, datë 19. 03.2026

PËR

**MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURËS PËR HAPJEN DHE MARRJEN E
LICENCËS PËR PROGRAMIN E KUALIFIKIMIT "UDHËRRËFYES TURISTIK
KOMBËTAR"**

Në mbështetje të nenit 3 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 05.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", i ndryshuar; nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 15 dhe nenit 72 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve me nr. 748 prot., datë 18.03.2026, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të nisjes së procedurave për hapjen dhe pajisjen me licencë të programit të kualifikimit "Udhërrëfyes Turistik Kombëtar", në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
2. Ngarkimin e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve për ndjekjen e mëtejshme të procedurave administrative dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Ky program do të administrohet në nivel Rektorati.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Zëvendësrektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve ndihmës-akademike dhe Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të tretët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ**

